



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRËN

02 Nr. / Br 1120/23

Nr. i fq. / Br. sf -05-

Data / Datum 29.09.2023

VUSHTRRI - VUÇITRËN



KOMUNA VUSHTRRI

KRYQI I KUQ I KOSOVËS

Bazuar në nenin 5, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 paragrafi 1.4 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 158/23 datë 30.06.2023, palët:

- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna)
- dhe
- Kryqi i Kuq i Kosovës përfaqësuar nga znj. **Feride Hyseni**, Kryetare të Kryqit të Kuq të Kosovës (këtu e tutje, Kryqi i Kuq), lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

“Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri”

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit ” **Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri**” në parcelën kadastrale nr. P-70202016-02253-23 në sipërfaqe prej 500 m², zona kadastrale **Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë**, si dhe përcaktimi i obligimeve të Komunës së Vushtrrisë dhe Kryqit të Kuq të Kosovës për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit dhe financimi

2.1 Vlera e përgjithshme e projektit ” **Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri**” është 89,999.09 € (tetëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e nëntë cent).

2.2 Kryqi i Kuq i Kosovës financon këtë projekt me 60% të vlerës së përgjithshme të projektit ose 53,999.45 € (pesëdhjetë e tremijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e katërdhjetë e pesë cent).

2.3 Komuna e Vushtrrisë financon me mjete financiare nga buxheti i saj në këtë projekt me 40% ose 35,999.63 (tridhjetë e pesëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë e tre cent). Këto mjete do të i transferohen Kryqit të Kuq të Kosovës si vijon: 15,000.00 € në vitin 2023 dhe 20,999.63 € në vitin 2024.

2.4 Çdo obligim shtesë që mund të dal mbi shumën e shënuar në pikën 2.1 të këtij neni do ta financoj Kryqi i Kuq i Kosovës.

2.5 Mjetet financiare eventualisht të mbetura pas përfundimit të projektit nga kjo marrëveshje duhet të iu kthehen bashkëfinancuesve sipas përqindjes së mjeteve me të cilat kanë participuar në projekt.

Neni 3 Realizimi i projektit

Projekti "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtri" do të realizohet brenda viteve 2023/2024, në bazë të projektit zbatues që do ta siguroj Kryqi i Kuq i Kosovës.

Neni 4 Obligimet e Kryqit të Kuq të Kosovës

4.1 Kryqi i kuq i Kosovës siguron mjetet nga neni 2 pika 2.2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje të dokumentit mbi sigurimin e mjeteve e dërgon në Komunë.

4.2 Kryqi i Kuq i Kosovës obligohet që projektin "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq në Vushtri" të e realizoj në pajtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik të Kosovës dhe legjislacionin tjetër përcjellës të kësaj fushe.

4.3 Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasisë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për kryerje të pagesës së punëve/furnizimeve në bazë të kushteve të kontratës.

4.4 Kryqi i Kuq i Kosovës obligohet që me rastin e nënshkrimit të kontratës ta pajis komunën e Vushtrrisë me dokumentin origjinal të kontratës së nënshkruar si dhe të njoftoj Komunën për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë apo cilësisë gjatë implementimit të projektit dhe për këtë kërkon pëlqimin e komunës së Vushtrrisë.

4.5 Kryqi i Kuq i Kosovës obligohet që të vendosë në vend punishte tabelën informuese (Panon) me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.

4.6 Kryqi i Kuq i Kosovës, për të realizuar pagesat nga komuna për punët/furnizimet e kryera duhet të kompletoj këto dokumente:

4.6.1 Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korigjimit të çmimeve të dorëzohen çmimet e korigjuara),

4.6.2 Ta pajis komunën e Vushtrrisë me ofertën financiare të verifikuar nga origjinali prej zyrtarit kompetent të prokurimit të Kryqit të Kuq të Kosovës.

4.6.3 Vendimin mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës.

4.6.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës apo komisionit të pranimit për punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).

4.6.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga Kryqi i Kuq i Kosovës.

4.6.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, numrin e llogarisë bankare dhe letërnjoftimit të pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SIMFK-Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave).

4.7 Kryqi i Kuq i Kosovës duhet të i ndërmerr të gjitha masat që mjetet e ndara nga kryqi i kuq për këtë projekt sipas nenin 2 pika 2.2 të kësaj marrëveshje të realizohen gjatë vitit 2023 dhe 2024.

4.8 Kryqi i Kuq i Kosovës obligohet që ti dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji me të cilin raportohet rreth ecurisë së projektit dhe t'a paraqes progresin e kontratës duke përfshirë këtu edhe progresin e pagesave deri në përfundim të projektit.

Neni 5 Obligimet e Komunës

5.1 Komuna e Vushtrrisë i zoton mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshje dhe një kopje të dokumentit me të cilin dëshmohet se janë zotuar mjetet e dërgon në Kryqin e Kuq të Kosovës.

5.2 Pagesat nga Komuna për bashkëfinancim të projektit “Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq dega në Vushtri” do të bëhen sipas dinamikës së kryerjes së punëve dhe pas pranimit të raportit nga menaxheri i kontratës për punët e përfunduara.

5.3 Pagesat do të kryhen nga buxheti i komunës - fondi për bashkëfinancim.

5.4 Komuna e Vushtrrisë cakton një zyrtar monitorues i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës. Në rast se vëren parregullsi gjatë realizimit të projektit/kontratës, e njofton Menaxherin e kontratës si dhe Menaxhmentin e Komunës .

Neni 6 Pronësia e projektit

Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik dhe pranimi ë përkohshëm dhe pas përfundimit të periudhës së defekteve eventuale, bëhet pranimi përfundimtar me ç' rast ky investim (objekti) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit regjistrohet në RDPP në pronësi të Komunës së Vushtrrisë dhe Kryqit të Kuq të Kosovës sipas përqindjes së mjeteve financiare me të cilat kanë kontribuar në implementimin e këtij projekti, ndërsa toka (trualli) mbetet në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 7 Shfrytëzimi i objektit

7.1 Detajet rreth shfrytëzimit të hapësirave të objektit do të definohen nga një komision i përbashkët prej 4 anëtarësh, prej të cilëve dy nga Kryqi i Kuq i Kosovës dhe dy nga Komuna e Vushtrrisë.

7.2 Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Vushtrri do t'i shfrytëzoj për nevoja të veta në afat të pa caktuar dhe pa kompensim hapësirat e përcaktuara, në objektin e ndërtuar sipas kësaj marrëveshje pas definimit të shfrytëzimit të hapësirave nga komisioni i cekur në pikën paraprake të këtij neni.

Neni 8 Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

8.1 Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

8.2 Komuna mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se Kryqi i Kuq i Kosovës nuk i përmbushë obligimet e veta të dala nga kjo marrëveshje.

Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

Nr. 10 Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për palën tjetër nënshkruese. Marrëveshja përmban 11 nene në pesë (5) faqe A/4.

